

## **PhD në Shëndetin Publik Urban e financuar nga Qeveria Zvicerane**

### **Tema:**

Qëllimi i projektit të doktoratës (PhD) është të zhvillojë një koncept për komunitetet e shëndetshme dhe miqësore ndaj moshës në Kosovë. Kuadri i hulumtimit janë komunat gjysmë urbane dhe urbane ku është zbatuar një studim kohort në bashkëpunim me mjekët familjar. Në bashkëpunim me pjesëmarrësit e kohortës, do të identifikohen boshllëqet e qytetit të shëndetshëm. Ndikimi i *urban farming* në mirëqenien dhe shëndetin mendor të pjesëmarrësve në kohortë do të testohet në kontekstin e një studimi ndërhyrës.

### **Çfarë presim nga kandidati:**

Kandidati për PhD pritet të ketë një diplomë Master ose diplomë ekuivalente universitare të njohur nga një universitet zviceran. Studentët e masterit nga fusha të ndryshme (mjekësi, infermieri, farmaci, biologji, inxhinieri mjedisore, planifikim urban, arkitekturë, psikologji, shkencë sociale) me interes në shëndetin publik do të merren parasysh.

Data e lindjes së aplikantit duhet të jetë pas 31 dhjetorit 1986.

Kandidati për doktoratë duhet të përgatisë të gjitha dokumentet përkatëse duke përfshirë një propozim të hulumtimit para afatit të fundit të paraqitjes më 30 nëntor 2021. Projekti i doktoratës do të fillojë në shtator 2022.

### **Ajo që ne i ofrojmë kandidatit:**

Paga e kandidatit do të paguhet përmes një Burse të Ekselencës të Qeverisë Zvicerane ([https://www.sbf.admin.ch/sbf/en/home/education/scholarships-and-grants/swiss-government-excellence-scholarships.html?fbclid=IwAR2gFhfQviiQwKYz-N-IRxem5vhC\\_mUZQxT3CVDZJiHXCljfvIdH2\\_2JQZ4#557188199](https://www.sbf.admin.ch/sbf/en/home/education/scholarships-and-grants/swiss-government-excellence-scholarships.html?fbclid=IwAR2gFhfQviiQwKYz-N-IRxem5vhC_mUZQxT3CVDZJiHXCljfvIdH2_2JQZ4#557188199)).

Kandidati do të përfundojë kurset e doktoratës (PhD) në Zvicër dhe do të kryejë studimet e doktoratës në The Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH). Projekti i doktoratës (PhD) do të implementohet në Kosovë.

**Afati i fundit për aplikim:** 15 tetor 2021. Aplikimi përbëhet nga një CV; vërtetimi i diplomës master; letër motivuese prej 2 faqesh në maksimum. Materiali i aplikimeve në gjuhën angleze duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike në programin Accessible Quality Healthcare (AQH) në [kosco@aqhproject.org](mailto:kosco@aqhproject.org).